

# UJËRAT NDËRKUFITARE

SHKODËR 15-16 NËNTOR 2017

# PËRMBAJTJA

- INFORMACION I PËRGJITHSHËM
- LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR/KOMBËTAR
- MARRËVESHJE DY/SHUMË PALËSHE
- KUADRI INSTITUCIONAL (KOMISIONE/KOMITETE ETJ)
- ROLI I KBU/ABU NË MENAXHIMIN E UJRAVE NDËRKUFITARE
- REKOMANDIME PËR TË ARDHMEN

# BASENET UJORE NDËRKUFITARE

□ Në territorin e Shqipërisë dy basene ujore janë në nivel ndërkufitar:


- ❖ Baseni ujq Drin-Bunë ndahet me Maqedoni, Greqi, Mal i Zi dhe Kosovë
- ❖ Baseni ujq Vjosa ndahet me Greqinë.

□ Shqipëria ka tre liqene kryesore të cilët janë në nivel ndërkufitar:

- ❖ Liqeni i Shkodrës, i ndarë me Malin e Zi;
- ❖ Liqeni i Ohrit, i ndarë me Maqedoninë;
- ❖ Liqeni i Prespës, i ndarë me Greqinë dhe Maqedoninë

# BASENI UJOR DRIN – BUNË

- Sip = 6.998 km<sup>2</sup>
- Popullsia = 437.686
- Prurja vjetore = 680 m<sup>3</sup>/s
- Zona të mbrojtura = 10
- Stacione monitorimi = 5



# LEGJISLACIONI NDËRKOMBËTAR / KOMBETAR

KONVENTA NDËRKOMBËTARE	LEGJISLACIONI KOMBETAR
<input type="checkbox"/> Konventa ESPOO për “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkufitar“ e vitit 1991;	Ligj nr. 111/2012 për “Menaxhimin e Integruar të burimeve ujore”
<input type="checkbox"/> Konventa e Helsinkit “Për mbrojtjen dhe përdorimin e ujërave ndërkufitare dhe liqeneve ndërkombëtare”, e vitit 1992.	Ligj Nr. 91/2013 për “Vlerësimin Strategjik Mjedisor”
<input type="checkbox"/> Konventa Ramsar mbi “Ligatinat me rëndësi ndërkombëtare veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë” e vitit 1971, e ndryshuar 1987 dhe 1994;	Ligj Nr.10 440, datë 7.7. 2011 për “Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”
<input type="checkbox"/> Konventa e Barcelonës “Mbrojtja e mjedisit detar dhe rajonit bregdetar të Mesdheut” e vitit 1995	Ligj Nr. 9700, datë 26.3.2007 për “Mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkufitare”
<input type="checkbox"/> Konventa e Vjenës "Për të drejtën e traktateve".	Ligj Nr .9103, date 10.7.2003 për “ mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare”
	Vendim Nr. 598, datë 1.7.2015 për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitare”

# MARRËVESHJE DY/SHUMË PALËSHE

## □ MAQEDONI

5.12.1956

Marrëveshja midis Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë mbi çështjet e ekonomisë ujore”

2004

Marrëveshja për liqenin e Ohrit “ mbrojtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i liqenit të Ohrit dhe basenit të tij

25.11.2011

Memorandumi i Mirëkuptimit – Drini një vizion i përbashkët, për menaxhimin e qëndrueshëm të basenit të Drinit.

Në vitin 2013 draft marrëveshje e re për ujërat ndërkufitare, nuk ka reagim zyrtar nga ana tyre

# MARRËVESHJE DY/SHUMË PALËSHE

## □GREQI

3.4.2003

Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë për “krijimin e Komisionit të Përhershëm Shqiptaro-Grek mbi çështjet e ujërave të ëmbla ndërkufitare”

2003

Memorandumi i Mirëkuptimit në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

25.11.2011

Memorandumi i Mirëkuptimit – Drini një vizion i përbashkët, për menaxhimin e qëndrueshëm të basenit të Drinit.

Marrëveshja trepalëshe “Për shpalljen Rezervë Ndërkufitare Biosferë të Rajonit Ohër-Prespë”, ndërmjet Shqipërisë, Maqedonisë dhe Greqisë, e firmosur nga pala shqiptare dhe maqedonase në vitin 2012, por jo nga pala greke.

# MARRËVESHJE DY/SHUMË PALËSHE

## □MALI ZI

2003

Memorandumi i Mirëkuptimit "Për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe parimit të zhvillimit të qëndrueshëm"

13.2.2003

Marrëveshja mbi problemet ujore, Statuti i Komisionit të përbashkët ndërqeveritar shqiptaro malazez për trajtimin e ujërave kufitare

2008

Marrëveshja për "Menaxhimin e pellgut ujëmbledhës të liqenit të Shkodrës".

2010

Memorandumi i Mirëkuptimit "Për rregullimin e regjimit ujqor të lumit Drin, Buna dhe liqenit të Shkodrës, situata pas përmbytjeve"

Mali i Zi ka përcjellë një draft marrëveshje të re për ekonominë ujore. Në proces diskutimi ende.

# MARRËVESHJE DY/SHUMË PALËSHE

## □KOSOVE

25.11.2011

Memorandumi i Mirëkuptimit – Drini një vizion i përbashkët, për menaxhimin e qëndrueshëm të basenit të Drinit.

Dorëzuar një draft marrëveshje për ujërat ndërkufitare nga pala shqiptare, nuk asnjë reagim zyrtar.

# KUADRI INSTITUCIONAL

## □ KOMISIONI PËR UJRAT NDËRKUFITARE

- ❖ VKM nr. 177 datë 26.3.2014 “Për ngritjen, përbërjen, funksionimin, përgjegjësitë dhe detyrat e Komisionit të posaçëm për administrimin e ujërave ndërkufitare” (e *ndryshuar..*)
- ❖ Anëtarë ministrat e linjës të lidhur me çështjet e ujit
- ❖ Komisioni harton, shqyrton dhe propozon marrëveshje bashkëpunimi me secilin vend fqinj
- ❖ Komisioni trajton të gjitha çështjet që lidhen me menaxhimin e integruar të burimeve ujore në nivel ndërkufitar
- ❖ Nën mbikqyrjen e Komisionit janë ngritur nënkomisione për çështjet e ujërave ndërkufitare (*rasti: Radika*)
- ❖ STKKU (**sot anëtar i Komisionit**) ka realizuar të gjithë punën mbështetëse / organizative në mbarëvajtjen e punës së tij

# KUADRI INSTITUCIONAL

## STRUKTURA NË NIVEL NDËRKUFITAR

- Komisioni i përbashkët në vitin 2010, në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit “Për rregullimin e regjimit ujor të lumit Drin, Buna dhe liqenit të Shkodrës, situata pas përmbytjeve”, Shqipëri – Mal i Zi. (Komisioni ka ngritur grupe pune respektivisht nga secila Palë)
- Komisioni dypalësh në zbatim të Marrëveshjes për ujërat e përbashkëta ndërkufitare. Aktualisht nuk është funksional.
- Komiteti i liqenit në zbatim të Marrëveshjes për “Menaxhimin e pellgut ujëmbledhës të liqenit të Shkodrës” , Shqipëri – Mal i Zi, 2008. Komiteti nuk ka funksionuar rregullisht.
- Komiteti i liqenit në zbatim të Marrëveshjes për “Menaxhimin e pellgut ujëmbledhës të liqenit të Ohrit” , Shqipëri – Maqedoni 2004. Komiteti ka funksionuar rregullisht.
- Grupe pune ekspertësh (të përbashkët), në zbatim të Memorandumi i Mirëkuptimit “Drin - Një vizion strategjik i përbashkët”, në 2013.

# ROLI I KBU / ABU NË MENAXHIMIN E UJËRAVE NDËRKUFITARE

- ❑ Aktualisht roli i KBU-së dhe ABU-së në lidhje me menaxhimin e ujërave ndërkufitare është jo i qartë
- ❑ Përfshirja e tyre në proceset vendimarrëse / planifikuese dhe zbatuese ka qënë e kufizuar
- ❑ Përfaqësia e tyre në strukturat dy / shumë palëshe ka munguar
- ❑ Hartimi i planit të menaxhimit (rasti i baseneve ndërkufitare) konform dispozitave të Konventave ndërkombëtare dhe DKU-së së BE-së, si detyrë ligjore i takon Ministrisë / Sekretariatit, duke përjashtuar ABU-në → ka sjellë:
  - ❖ Mungesë përfshirje të ABU-së në proces,
  - ❖ Mungesë të informacionit në nivel ndërkufitar, për basenin ujor (diskutime të kryera, vendime të marra, etj)
  - ❖ Përjashtim nga procesi i planifikimit të masave për basenin ujor
  - ❖ Mungesë koordinimi ndërmjet vendimarrjes në nivel KBU dhe vendimeve të dakordësuara në nivel ndërkufitar

# REKOMANDIME PËR TË ARDHMEN

- ❖ ZHVILLIMI I DISKUTIMEVE ME STRUKTURAT PËRKATËSE TË VENDEVE FQINJE PËR ARRITJEN E MARRËVESHJEVE NË PROCES
- ❖ FORCIMI I ROLIT TË STKKU-SË NË KOORDINIMIN E PROCESIT TË MENAXHIMIT TË UJËRAVE NDËRKUFITARE
- ❖ FORCIMI I BASHKËPUNIMIT ME STRUKTURAT E TJERA TË NGRITURA PËR ÇËSHTJE TË TJERA MJEDISORE (GRUPE PUNE / KOMISIONE / KOMITETE PËR LIQENET, ZONAT E MBROJTURA, ETJ)
- ❖ REALIZIMI ME SERIOZITET I DETYRAVE DHE PËRGJEGJËSIVE QË DALIN NGA KUADRI LIGJOR (NDËRKOMBËTAR DHE AI KOMBËTAR)
- ❖ FORCIMI I KAPACITETEVE TEKNIKE DHE NJERËZORE NË NIVEL BASENI UJOR PËR REALIZIMIN E PLANEVE TË MENAXHIMIT DHE SHKËMBIMIN E TË DHËNAVE ME VENDET FQINJE



implemented by



Technical Secretariat of the  
National Water Council

**FALEMINDERIT !**